



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

RAPORT INDIVIDUAL PËR KONSULTIMIT PUBLIK
PËR PROJEKTAKTIN

Projektvendim “Për miratimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës 2021-2026”

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

1. Titulli i Projektaktit:

Projektvendim “Për miratimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës 2021-2026”

2. Kohëzgjatja e konsultimeve:

Tetor 2020- Korrik 2021

3. Metoda e konsultimit:

- a) Takime me grupet e interesit
- b) Mbledhja e mendimeve dhe sugjerimeve, të dërguara nëpërmjet postës elektronike nga të interesuarat/interesuarit, në postën elektronike zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale¹
- c) Mbledhja e Këshillit Konsultativ Qeveri Qendrore – Vetëqeverisje Vendore, datë datë 28 Shtator 2021.
- d) Draft- Agjenda Kombëtare për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës 2021-2026” është publikuar për konsultim publik në datën 12 gusht 2021 në adresën: <http://www.shendetesia.gov.al/>

4. Palët e interesit të përfshira:

Ministritë e linjës, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, INSTAT, Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioneri për Mbrojtjen e të dhënave personale, AMA, organizatat e shoqërisë civile. Gjithashtu janë përfshirë rregullisht në takimet parapërgatitore dhe ato konsultuese edhe përfaqësuese dhe përfaqësues nga Departamenti për Zhvillim dhe Mirëqeverisje pranë Kryeministritë.

Gjithsej *të angazhuar aktivisht* me dhënie komentesh në takimet parapërgatitore dhe ato konsultuese, si dhe me shkrim, rezultojnë Ministritë e linjës, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, INSTAT, Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioneri për Mbrojtjen e të dhënave personale, AMA, organizatat e shoqërisë civile, si edhe fëmijë.

¹ Këto mendime janë përcjellë pas takimeve online, si dhe në periudha ndërmjet përmirësimit të drafteve të dokumentit nga ana e Grupit Ndërinstitucional të Punës. Korrespondenca është mbajtur nëpërmjet adresave zyrtare të stafit të Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (kryesisht nëpërmjet adresave të Sektorit të Politikave dhe Strategjive të Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore).

Të pranishëm në takimet parapërgatitore dhe konsultuese ishin Ministrinë e linjës, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, organizatat e shoqërisë civile, si edhe fëmijë.

Të ftuar në takimet parapërgatitore dhe konsultuese ishin *institucione qendrore dhe vendore, institucione të pavarura dhe organizata të shoqërisë civile dhe fëmijë.*

Të angazhuara në mbështetje të gjithë punës së GNP-së ishin 3 ***eksperte*** për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve për hartimin e dokumentit, përgatitjes së tabelës së indikatorëve, tabelës së kostimit. Këto janë bërë me mbështetjen e UNICEF.

Grupi Ndërinstitucional i Punës për hartimin e AKDF 2021 – 2026 i ngritur me Urdhër të Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 519 datë 23.09.2020 “Për ngritjen e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Hartimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021 – 2025”, përbëhej nga **10 institucione** dhe gjithsej 16 anëtarë.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar pjesërisht/refuzuara.

| Çështja e adresuar | Komenti | Palët e interesuara | Vendimi | Justifikimi |
|--|---|--|----------------|---|
| | Ne formatin excel te pashaportave te indikatoreve, lutem te plotesohen targetet e synuara per secilin indicator, pasi nuk jane plotesuar. Kjo ka shume rendesi pasi mundeson nje monitorim real te arritjes se synimeve. | Njësia e Politikave për Zhvillim dhe Mirëqeverisje / Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes/ KRYEMINISTRIA | Pranuar | Tabela është plotësuar me targetet, që tashmë janë konfirmuar nga institucionet përgjegjëse. Në mungesë të konfirmimeve më të detajuara, tabela paraqet vetëm informacionin e paraqitur. |
| | Ne formatin excel te PV, lutem te verifikohet edhe njehere tabela, pasi jane disa institucione pergjegjese per zbatimin e masave te paplotesuara, si edhe nuk jane plotesuar afatet e synuara per zbatimin e tyre/masave. | Njësia e Politikave për Zhvillim dhe Mirëqeverisje / Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes/ KRYEMINISTRIA | Pranuar | Është verifikuar edhe njëherë tabela, duke lënë nga një institucion, në shtyllën e institucioneve përgjegjëse, por sqarohet se nuk mund të bëhet te të gjitha shtyllat përgjegjëse, pasi nuk mund ta shmangim këtë vendosje. Po kështu është reflektuar dhe sugjerimi lidhur me plotësimin e afatet të synuara për zbatimin e masave. |
| I.1.3.a. Planifikimi dhe kryerja e anketës studimore të treguesve të shumëfishhtë për fëmijët (MICS) | Duke qënë se 2022 INSTAT do të jetë i angazhuar në kryerjen e CENS, planifikimi dhe kryerja e MICS do të fillojë në 2023 dhe mendohet të kryhet në 2024 | INSTAT | Pranuar | |
| I.1.3.b Analiza e përditësuar e situatës së fëmijëve me aftësi të kufizuar, bazuar edhe në rezultatet e Censi dhe MICS | Gjithashtu raporti i analizës mendohet të jetë gati në vitet 2025-2026 | INSTAT | Pranuar | |

| | | | | |
|--|--|--------|----------|--|
| I.1.3.e Fuqizimi i mekanizmave dhe kapaciteteve të mbledhjes dhe raportimit të të dhënave me fokus fëmijët në nivel bashkie (për të paktën 5 bashki) | Jo INSTAT institucioni përgjegjës, masa ka nevojë të rikonturohet mbarë | INSTAT | Pranuar | |
| Masa IV.1.1. Aksesit dhe përfshirja e fëmijëve në mjedisin digjital Masa IV.1.2 Nxënia dhe kreativiteti në mjedisin digjital | Kjo mase duhet riformuluar, me qëllim harmonizimin e saj me Strategjinë kombëtare për sigurinë kibernetike dhe AKCESK si institucioni përgjegjës për sigurinë kibernetike në nivel kombëtar / AKSHI si institucion përgjegjës për ngritjen dhe menaxhimin e të gjitha infrastrukturave të TIK, në nivel kombëtar/ ASHMDF si institucioni përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve. Kjo mase është nominuese vetëm për një projekt, nderkohe që ekzistojnë objektiva dhe nderveprime institucionale të tjera të cilat sigurojnë mbështetje të tjera në këtë drejtim. Nderkohe, çdo element sigurie të rrjeteve dhe netëork, është subjekt i ligjit për sigurinë kibernetike. Në këtë kusht kjo mase del e panevojshme. | AKCESK | Refuzuar | Masa është e lidhur ngushtë me aftësimin digjital rreth TIK dhe sigurisë online, të dyja prioritetet kombëtare dhe në nivel evropian (Strategjia e Re Evropiane Për të Drejtat e Fëmijës). Sic vihet re masa gjithashtu lidhet ngushtë me masat e parashkikuara në Strategjinë e Re të Arsimit (22-26) si dhe me Strategjinë për Sigurinë Kibernetike (20-25). Të diskutuara dhe të pilotuara në disa nivele, aktivitetet janë në linjë me të gjitha investimet e 2 strategjive të sipërpërmendura. Në lidhje me infrastrukturën, AKSHI dhe Ministria e Arsimit kanë angazhimin institucional të përshkruar në Strategjinë përkatëse. Ndërkohë elementët e sigurisë së rrjeteve dhe network janë të përshkruara në përputhje me Strategjinë për Sigurinë Kibernetike (Objektivi Strategjik 6.3.2), vecanërisht mjediset publike me EëFI Miqësor për fëmijët. |
| II.1.1.dh Ndërgjegjësimi i komunitetit shkollor dhe krijimi i | Duke marrë në konsideratë përdorimin në mase të internetit nga prindërit dhe fëmijë, | AKCESK | Pranuar | |

| | | | | |
|--|---|--------|----------|---|
| një kulture pozitive që nuk pranon dhunën, bullizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm | fenomene te tilla hasen me se shumti ne mjedisin online. Per kete qellim, eshte i nevojshme koordinimi dhe perfshirja e CVE dhe AKCESK | | | |
| II.2.2.g Krijimi i sistemit për identifikimin, parandalimin dhe raportimin e dhunës, bullizmit dhe ekstremizmit në shkolla | Te gjitha sistemet /hardëare dhe softëare jane competence e AKSHI. Gjithashtu, duhet te konsiderohet sistemi/platforma aktuale qe menaxhohet nga AKCESK per raportimin e faqeve me permbajtje te paligjshme dhe te demshme e cila duhet t epromovohet neper te gjitha shkollat. | AKCESK | Refuzuar | Masa nënkupton krijimin e një sistemi për identifikimin parandalimin dhe raportimin që nuk përfshin vetëm sistemet hardëare dhe software por një mekanizëm të tërë që siguron që institucionet e përfshira të bashkëveprojnë brenda këtij sistemi. AKCESK është shtuar si institucion partnerë. |
| II.2.2.1 Forcimi i kapaciteteve të Linjës Kombëtare falas 116-006, dhe Aplikacionit “Raporto dhe Shpëto” për të mundësuar këshillimin dhe raportimin e rasteve të mundshme të TQNJ | Eshte e domosdoshme qe linjat kombetare te jene institucionale dhe me tej duhet te shfrytezohe platforma si ne komentin e pikes II.2.2.g | AKCESK | Pranuar | Linja Kombëtare falas 116-006 është një linjë kombëtare institucionale |
| II.3.1.f Krijimi i një portali qendror në Autoritetin e Telekomunikimit Elektronik (AKEP) për ofruesit e shërbimeve të Internetit për të siguruar reagime në kohë reale për zgjidhjen IP, kërkesa të të dhënave dhe teknologjisë së përdoruesve të fundit në lidhje me abuzimin dhe shfrytëzimin seksual të fëmijëve në internet | Shih komentet per kete aktivitetet. Portali eshte i ngritur prane AKCESK | AKCESK | Pranuar | |
| II.3.1.g Ngritja e kapaciteteve të personelit të gjyqësorit, prokurorisë dhe policisë,dhe të institucioneve të tjera ligjzbatuese të sistemit të drejtësisë për të identifikuar në | Institucioni pergjegjes per sigurine kibernetike eshte AKCESK dhe nuk eshte i perfshire??!!!! | AKCESK | Pranuar | |

| | | | | |
|--|---|---------------------------|----------------|--|
| <p>kohë dhe adresuar shpejt rastet e fëmijëve viktime të abuzimit seksual online, në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve në internet dhe sigurinë kibernetike, duke përfshirë evidenca të përdorimit digjital dhe ndihmën e ndërsjellë juridike</p> | | | | |
| <p>I.1.1.ç Fuqizimi i institucioneve të pavarura të të drejtave të njeriut në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve”,</p> | <p>Avokati i Popullit, si një institucion kushtetues dhe i pavarur nuk ka detyrim ligjor institucional zbatimin e vendimeve të Këshillit të Ministrave, në ato raste, kur fusha e veprimit dhe çështjet që kërkohen të rregullohen nëpërmjet tij, janë brenda sferës së kompetencave të ekzekutivit. Thënë kjo, efektet juridike të këtij vendimi nuk shtrihen për institucionet e pavarura kushtetuese, sikundër AP është, pasi ai ngarkon me detyrim e përgjegjësi të gjitha institucionet shtetërore, në nivel qendror dhe vendor. Dhe, referuar përcaktimeve të dhëna në legjislacionin në fuqi, konkretisht, ligjit nr.90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e organeve të administratës shtetërore”, institucione shtetërore në nivel qendror dhe vendor, janë institucionet në varësi të Kryeministrit dhe ministrave, si dhe degët e tyre territoriale. Neni 34, i ligjit nr.18/2017 “Për mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijës”, parasheh mekanizmat institucionalë këshillimorë dhe koordinues, për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, si dhe strukturat përgjegjëse për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës. Dhe, është pikërisht,</p> | <p>Avokati i Popullit</p> | <p>Pranuar</p> | |

| | | | | |
|------------------------------------|--|--------------------|----------|---|
| | <p>Avokati i Popullit, që në zbatim të pikës 7, të nenit 34, të ligjit të sipërcituar, monitoron dhe mbikqyr zbatimin e këtij ligji nga mekanizmat shtetërorë përgjegjës, në përputhje me Konventën për të Drejtat e Fëmijëve, si dhe në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr.8454, datë 4.2.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar.</p> <p>Natyrisht, që shtimi i kapaciteteve në burime njerëzore dhe materiale buxhetore për institucionet e pavarura kushtetuese (psh.Avokati i Popullit), është një element kyç i dëshmisë së pavarësisë dhe panaësisë së tyre, në ushtrimin e veprimtarisë kushtetuese, ligjore dhe administrative. Por, në thelb, kjo është një çështje, e cila i duhet adresuar organit të legjislativit, pra Kuvendit.</p> | | | |
| | <p>Gjithashtu, në draftagjendë nuk janë parashikuar masa të posaçme, për të garantuar të drejtat e fëmijës për t’u argëtuar, për të pasur një fillim të mirë në jetë, të rriten të lumtur dhe të shëndetshëm, si dhe të zhvillohen në potencialin e tyre të plotë. Kjo përfshin të drejtën për të jetuar në një planet të pastër dhe të shëndetshëm, për t’u çlodhur, për të luajtur, si dhe për t’u përfshirë e kënaqur në veprimtari kulturore dhe artistike, në një mjedis sa më të shëndetshëm e të pastër. Edhe familjeve dhe komunitetit, duhet t’u sigurojmë mbështetjen e nevojshme, në mënyrë, që ata t’u sigurojnë fëmijëve mirëqenie dhe zhvillim.</p> | Avokati i Popullit | Refuzuar | <p>Agjenda ka përcaktuar masa që përfshijnë garantimin e të drejtave të fëmijëve si e drejta për të marrë pjesë, e drejta për rritur në një kujdes familjar, etj</p> <p>Gjithashtu Agjenda ka parashikuar masa që përcaktojnë përfshirjen në veprimtari argëtuese dhe kulturore si ngritja e 10 qendrave kulturore.</p> |
| IV.1.2.b Ndërgjegjësimi i nxënësve | Sugjerojmë të shtohet KDIMDP si dhe | Komisioneri për të | Pranuar | |

| | | | | |
|---|---|--|----------|---|
| për sigurinë në Internet, privatësinë, ndarjen e informacionit dhe antiviruseve | institucione të tjera të cilat kanë në kompetencë të tyre monitorimin e sigurisë në internet, etj. Duke u bazuar në këtë masë të parashikuar ju bëjmë me dije se, Zyra e Komisionerit ka si pjesë të programit të saj vjetor të punës edhe aktivitete/ fushata ndërgjegjësuese mbi mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale tek fëmijët. | drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale | | |
| | Sugjerojmë të shtohet si masë e re edhe në Planin e Veprimit <i>II.2.1.f Miratimi i ligjit të ri për mbrojtjen e të dhënave personale, i përafuar me Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave Personale (GDPR)</i> | Komisioneri për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale | Pranuar | |
| Objektivi strategjik II.2. Funksionimi i një sistemi gjithëpërfshirës dhe efektiv për mbrojtjen e fëmijëve, përkatësisht ii: “Ndryshimi i dispozitave procedurale penale në Kodin e Procedurës Penale dhe miratimi i akteve rregullatore lidhur me parashkrimin e veprave penale lidhur me abuzimin seksual të fëmijëve”, | Ministria e Drejtësisë vlerëson se Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, është ligji i posacëm i cili trajton elementë material dhe procedural për të miturit autorë të veprave penale dhe viktimat të veprave penale. Në nenin 41 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, ka parashikim të vecantë për marrjen në pyetje të viktimave të abuzimit seksual. Ndërsa për sa lidhet me rregullat e parashkrimit të veprave penale të abuzimit seksual, ky institut parashikohet në Kodin Penal, dhe jo në Kodin e Procedurave Penale. Afatet e parashkrimit në Kodin Penal kanë pësuar ndryshime në vitin 2017, duke përcaktuar afate mjaft të gjata dhe aktualisht ky institut nuk është planifikuar të ndryshohet nga Ministria e Drejtësisë. | Ministria e Drejtësisë | Refuzuar | Në përshkrimin narrativ të analizës së situatës janë shprehur arsyet e nevojës për ndryshime në Kodin e Procedurës Penale, duke iu referuar referencave të studimeve dhe vështirësive të identifikuara nga institucione të ndryshme |
| Objektivi strategjik II.2. Funksionimi i një sistemi | Ministria e Drejtësisë vlerëson se ky objektivi është i paqartë se çfarë kërkohet të | Ministria e Drejtësisë | Refuzuar | Komenti si më sipër. Në pjesën përshkruese të masave të |

| | | | | |
|---|--|-------------------------------|-----------------|---|
| <p>gjithëpërfshirës dhe efektiv për mbrojtjen e fëmijëve, përkatësisht iv: “Ndryshimi i dispozitave procedurale penale në Kodin e Procedurës Penale dhe miratimi i akteve rregullatore lidhur me procedurat dhe afatet e nevojshme për të rritur efikasitetin e hetimit, prioritizimin e rasteve dhe analizën e provave lidhur me rastet e abuzimit seksual të fëmijëve nëpërmjet internetit dhe teknologjive të komunikacionit”,</p> | <p>ndryshohet konkretisht në Kodin e Procedurës Penale. Kjo për shkak se mjetet e hetimit, afatet dhe vleftësimi i provave në procesin penal bazohen në rregulla strikte të cilat përbëjnë bazën e procedimit penal.</p> | | | <p>propozuara faqe 41.</p> |
| <p>Aktivitetin II.2.1.a “Rishikimi i Kodit të Familjes në kuadër të harmonizimit me ndryshimet ligjore të Ligjit 18/2017 për çështjet e mbrojtjes së fëmijëve dhe ligje të tjera që përmbajnë parashikime specifike për mbrojtjen dhe trajtimin e fëmijëve”,</p> | <p>sa i takon kërkesës për harmonizimin e Kodit të Familjes me ligjin nr. 18/2017, sqarojmë se në përputhje me hierarkinë e normave, të përcaktuar nga neni 116 i Kushtetutës, si dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, ligjet duhet të jenë në përputhje me kodet, si akte me fuqi më të lartë juridike, referuar edhe shumicës me të cilën miratohen këto akte në Kuvend. Për më tepër, pas vlerësimit të parashikimeve që përmban Kodi i Familjes, si dhe referuar dispozitave të ligjit nr. 18/2017, çmujmë se këto akte ligjore trajtojnë aspekte të ndryshme të së drejtës. Përkatësisht, Kodi i Familjes trajton parime të përgjithshme, institutet e së drejtës familjare dhe procedura të përcaktuara qartë lidhur me to, ndërsa ligji nr.18/2017 përcakton të drejtat dhe mbrojtjen që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse, që garantojnë me efektivitet ushtrimin, respektimin, promovimin e këtyre të drejtave, si dhe</p> | <p>Ministria e Drejtësisë</p> | <p>Refuzuar</p> | <p>Nga Kodi i Familjes, burojnë koncepte të rëndësishme udhëzuese të tilla si përgjegjësia prindërore, kujdestaria, kujdesi alternativ përfshirë familjen kujdestare dhe masat e mbrojtjes në të cilat mbështeten të gjitha aktet ligjore dhe rregullatore që adresojnë mbrojtjen e fëmijës nga të gjitha format e dhunës. Strategjia për të Drejtat e Fëmijëve parashikon rishikimin e Kodit të Familjes për të adresuar në mënyrë adekuate të gjitha boshllëqet dhe pengesat në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve dhe çështjen e birësimit. Sigurimi i qartësisë dhe harmonizimi i disa koncepteve ligjore në Kodin e Familjes do të garantojë nga njëra anë plotësimin e boshllëqeve të rëndësishme të sistemit aktual të</p> |

| | | | | |
|--|--|-------------------------------|----------------|--|
| | <p>mbrojtjen e veçantë të fëmijës. Lidhur me konceptin e “kujdestarisë ligjore”, sqarojmë se kujdestaria e caktuar nga gjykata në përputhje me dispozitat e Kodit të Familjes është në vetvete kujdestari ligjore. Nuk është i qartë kuptimi që Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale kërkon t’i japë këtij koncepti. Referuar caktimit të një moshe minimale përtej së cilës gjykata nuk mund të lejojë lidhjen e martesës për të miturin nën 18 vjeç, ky propozim do të mbahet në konsideratë nga strukturat përkatëse në Ministrinë e Drejtësisë për sa kohë kjo çështje është trajtuar më parë nga kjo strukturë, duke vlerësuar si moshë minimale 16 vjeç, në përputhje edhe me legjislacionin e vendeve europiane.</p> <p>Për sa më sipër, vlerësojmë përcjelljen e propozimeve konkrete lidhur me ndryshimin e dispozitave të Kodit të Familjes që prekin institutin e kujdestarisë, bazuar edhe në argumentin e sipërcituar. Ministria e Drejtësisë shpreh gatishmërinë për vlerësimin e nevojës mbi këto ndryshime pas kryerjes së një analize të detajuar të propozimeve tuaja.</p> | | | <p>mbrojtjes së fëmijëve, por gjithashtu një zbatim më harmonik të ligjeve dhe rregulloreve të ndryshme në fushën e mbrojtjes së fëmijëve dhe mbështetjen e familjes.</p> <p>Analiza përshkruese faqe 39-40 në pjesën përshkruese të masave.</p> |
| <p>II.2.1.c Hartimi dhe miratimi i ligjit “Për kujdesin alternativ”, në kuadër të përmirësimit të kornizës ligjore në sistemin e mbrojtjes, kujdesit të fëmijëve dhe sistemit të drejtësisë”</p> | <p>Aktivitetin II.2.1.c, sqarojmë se nisma për hartimin e një ligji për kujdesin alternativ, nuk bën pjesë në fushën e përgjegjësisë së Ministrisë së Drejtësisë, pasi lidhet me masat mbrojtëse për fëmijët dhe si e tillë është në fushën e përgjegjësisë së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në përputhje me shkronjën “e”, të pikës 3, të vendimit nr. 508, datë 13.09.2017 “Për</p> | <p>Ministria e Drejtësisë</p> | <p>Pranuar</p> | |

| | | | | |
|---|---|------------------------|---------|---|
| | përcaktimin e fushës së përgjegjesisë së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”. Për këtë arsye sugjerojmë heqjen e Ministrisë së Drejtësisë si institucion përgjegjës. | | | |
| Në lidhje me Aktivitetin II.2.1.ë “Miratimi i ndryshimeve në Ligjin e Birësimit”, | Sqarojmë se Ministria e Drejtësisë ka depozituar në Kuvend projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9695, datë 19.3.2007 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit”, të ndryshuar. Ky projektligj, në përputhje me nenin 87/1 të Rregullores së Kuvendit, për shkak të mbarimit të legjislaturës së punimeve të Kuvendit, është kthyer pranë Ministrisë së Drejtësisë, e cila ka si qëllim ripropozimin e tij. Gjithashtu, sqarojmë se instituti i kujdestarisë nuk gjen parashikim në ligjin nr.9695/2007, të ndryshuar, pasi janë institute të ndryshme, ndaj vlerësojmë qartësimin e kësaj mase, duke qenë se harmonizimi është kërkuar sa i takon institutit të kujdestarisë dhe jo birësimit. Për këtë arsye, nuk del e qartë nevoja e një mase të tillë. | Ministria e Drejtësisë | Pranuar | Është hequr Agjencia për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës si institucion përgjegjës. |
| II.2.1.j “Hartimi dhe miratimi i një udhëzimi të brendshëm ndërinstitucional në lidhje me njoftimin dhe heqjen e materialeve të paligjshme dhe të dëmshme të abuzimit seksual dhe shfrytëzimit të fëmijëve online”, | Në relacionin shpjegues të jepen argumenta konkrete mbi aktin ligjor në fuqi i cili autorizon miratimin e këtij udhëzimi në kushtet kur kjo masë nuk lidhet me fushën e përgjegjesisë së Ministrisë së Drejtësisë. | Ministria e Drejtësisë | Pranuar | |
| II.2.1.1 “Hartimi i udhëzimit të përbashkët ndërminister për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në vijim të zbatimit të VKM 129 - | Në relacionin shpjegues të jepen argumenta konkrete mbi aktin ligjor në fuqi i cili autorizon miratimin e udhëzimit të përbashkët | Ministria e Drejtësisë | Pranuar | Lidhur me këto akte do të ndryshojë forma e hartimit duke zëvendësuar - tek masa II.2.1.1 bëhet “Hartimi dhe miratimi i një |

| | | | | |
|--|---|-------------------------------|----------------|---|
| <p>Ngritja dhe fuqizimi i skuadrave të terrenit për identifikimin referimin dhe menaxhimin e rasteve e fëmijëve në nevojë për mbrojtje përfshirë fëmijët në situatë rruge, të shfrytëzuar ekonomikisht dhe fëmijëve viktima të trafikimit” dhe aktivitetin III.4.1.ë “Hartimi dhe miratimi i një udhëzimi të përbashkët midis ASHDMF dhe Qendrës së Parandalimit të krimeve të të miturve dhe të rinjve për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në konflikt me ligjin</p> | | | | <p>marrëveshje ndërministrorë për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në vijim të zbatimit të VKM 129 - Ngritja dhe fuqizimi i skuadrave të terrenit për identifikimin, referimin dhe menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje përfshirë fëmijët në situatë rruge, të shfrytëzuar ekonomikisht dhe fëmijëve viktima të trafikimit”</p> <p>Masa III.4.1.e bëhet “Hartimi dhe miratimi i një marrëveshje të përbashkët midis ASHDMF dhe Qendrës së Parandalimit të krimeve të të miturve dhe të rinjve për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në konflikt me ligjin</p> |
| <p>II.3.1.ç “Zhvillimi i programeve të trajnimit ndërsektorial të profesionistëve për ofrimin e shërbimeve të integruara për fëmijët viktima të abuzimit seksual dhe formave të tjera të rënda të dhunës dhe trajnimin e tyre (përfshin punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve, punonjësit e sistemit të drejtësisë, punonjësit e shëndetsisë, së arsimit, etj)”,</p> | <p>Sugjerojmë heqjen e Ministrisë së Drejtësisë si institucion përgjegjës duke qenë se kjo masë nuk bën pjesë në fushën e përgjegjësisë së saj.</p> | <p>Ministria e Drejtësisë</p> | <p>Pranuar</p> | |
| <p>II.3.1.dh “Ngritja e një sistemi kursesh pranë Shkollës së Magjistraturës dhe Akademinë e</p> | <p>Vlerësojmë që Ministria e Drejtësisë të zëvendësohet me Shkollën e Magjistraturës si institucion përgjegjës në përputhje me</p> | <p>Ministria e Drejtësisë</p> | <p>Pranuar</p> | |

| | | | | |
|--|--|-------------------------------|----------------|--|
| <p>Policisë për të ngritur kapacitetet teknike dhe njohuritë për policët, prokurorët dhe gjykatësit e rinj që lidhen me masat e mbrojtjes së fëmijëve, shërbimet shoqërore, për krimin kibernetik, të dhënat digjitale dhe abuzimin seksual online dhe shfrytëzimin e fëmijëve”,</p> | <p>ligjin nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i cili përcakton fushën e veprimtarisë së tij.</p> | | | |
| <p>II.3.1.g “Ngritja e kapaciteteve të personelit të gjyqësorit, prokurorisë dhe policisë,dhe të institucioneve të tjera ligjzbatuese të sistemit të drejtësisë për të identifikuar në kohë dhe adresuar shpejt rastet e fëmijëve viktime të abuzimit seksual online, në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve në internet dhe sigurinë kibernetike, duke përfshirë evidenca të përdorimit digjital dhe ndihmën e ndërsjellë juridike”,</p> | <p>Në lidhje me vlerësojmë që Ministria e Drejtësisë në këtë masë duhet të jetë institucion partner dhe jo përgjegjës duke mbajtur në konsideratë objektin e saj të veprimtarisë të përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.842, datë 27.09.2013 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Drejtësisë</p> | <p>Ministria e Drejtësisë</p> | <p>Pranuar</p> | |
| <p>III.4.1.c “Ofrimi i programeve të drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit për fëmijët në konflikt me ligjin”, si dhe për aktivitetin III.4.1.f “Ngritja e kapaciteteve të punonjësve të Qendrës së Parandalimit të krimeve të të miturve dhe të rinjve për menaxhimin e fëmijëve në konflikt me ligjin”</p> | <p>Vlerësojmë vendosjen si institucion përgjegjës të Qendrës së Parandalimit për Krimet te të Miturit, e cila është kompetente për zbatimin e kësaj mase, në përputhje me parashikimin e Vendimit nr.314/2019 të Këshillit të Ministrave “Për organizimin, funksionimin si dhe përcaktimin e rregullimeve specifike lidhur me strukturën dhe organikën e Qendrë së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve”.</p> | <p>Ministria e Drejtësisë</p> | <p>Pranuar</p> | |
| <p>III.4.1.ç “Miratim i një ligji të vecantë për pashtetësinë</p> | <p>të hiqet Ministria e Drejtësisë si institucion përgjegjës, pasi kjo masë është në fushën e</p> | <p>Ministria e Drejtësisë</p> | <p>Pranuar</p> | |

| | | | | |
|---|--|------------------------|---------|--|
| | përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme dhe nuk ka lidhje me objektin e veprimtarisë së Ministrisë së Drejtësisë. | | | |
| III.4.1.e “Funksionimi i Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur”, si dhe për aktivitetin III.4.1.gj “Ngritja e Institucionit të Edukimit dhe Rehabilitimit të të Miturve”, | Vlerësojmë se këto masa duhet të hiqen për të shmangur mbivendosjen pasi ato gjenden të reflektuara në Planin e Veprimit të Strategjisë së Drejtësisë për të Mitur 2018-2021 përkatësisht në Objektivin nr.2 objektivi specifik 3 masa 3.1 dhe Objektivin nr.4 objektivi specifik 5 masa 5.1. | Minsitria e Drejtësisë | Pranuar | |
| III.4.1.f togfjalëshi “për menaxhimin e fëmijëve në konflikt me ligjin | ” të zëvendësohet me “me qëllim realizimin e veprimtarisë rehabilituese dhe riintegruese nëpërmjet mbikëqyrjes dhe mbrojtjes të të miturve pas kryerjes së dënimit”. | Ministria e Drejtësisë | Pranuar | |
| | Në faqen 21 të dokumentit në nënndarjen “Zhvillimi në fëmijërinë e hershme dhe arsimit” mendojmë që procesi edukimit të shtrihet edhe përmes artit dhe kulturës me tematika të dedikuara në bashkëpunim me institucionet publike të artit dhe arsimit duke krijuar projekte të përbashkëta, mes tyre. Përtej arsimimit e formimit bazë, për një zhvillim psiko-social, fëmijët kanë të drejtë dhe nevojë për pjesëmarrje në aktivitete te ndryshme kulturore dhe artistike. Këto aktivitete të zhvillohen si në kuadër te programeve shkollore, ashtu dhe si pjesë e komunitetit, familjes dhe individualisht. | Ministria e Kulturës | Pranuar | |

| | | | | |
|--|--|--|---------|--|
| | <p>“Kultura dhe trashëgimia kulturore janë një pjesë shumë e rëndësishme e edukimit të fëmijëve me frymën e identitetit kombëtar, tolerancës fetare, njohjes dhe bashkëveprimit mes kulturave dhe minoriteteve. Programi “Edukimi Përmes PKulturës” e cila përfshin edhe trashëgiminë kulturore, i zbatuar nga Ministria e Kulturës dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë konsiston në një kalendar të qëndrueshem aktiviteteve të zhvilluara nga shkolla e grupe të ndryshme nxënësish, në institucionet e artit dhe kulturës, site arkeologjike, muze etj. Ky program ka për qëllim plotësimin e njohurive të marra në shkollë si dhe zhvillimin e aktiviteteve në kuadër të programeve shkollore.</p> | Ministria e Kulturës | Pranuar | |
| | <p>Në pikën 2 të projektvendimit të përcaktohen të gjithë ministritë dhe institucionet qendrore që ngarkohen me zbatimin e këtij vendimi, të shtohet “Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore”</p> | Agjensia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV) | Pranuar | |

| | | | | |
|---|--|--|---------|--|
| | Pjesa I pika 2.1, të shtohet ligji 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, vkm nr. 691, datë 29.7.2015 “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore”, të ndryshuar me vkm nr.783, datë 7.10.2020, si akte bazë për përgjegjësitë dhe detyrat e NjVV në fushën e shërbimeve sociale për fëmijët dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre. | Agjensia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV) | Pranuar | |
| | Plani i Veprimit 2021-2026 për fëmijët (Masa I.1.1.d) i parashikuar për 3 bashki deri ne vitin 2026, të shtrihet në të gjitha bashkitë e vendit dhe të përfundojnë brenda vitit 2023. Ngritja e strukturave të pjesëmarrjes së fëmijëve në nivel vendor (Masa I.1.4.a) i parashikuar në 4 bashki, të shtrihet në të gjitha bashkitë e vendit dhe të përfundojë brenda vitit 2023. Ngritja dhe fuqizimi i kapaciteteve të strukturave të mbrojtjes së fëmijës (Masa I.1.4.b) parashikuar deri ne vitin 2026, të përfundojë në të gjitha bashkitë, deri në vitin 2023. | Agjensia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV) | Pranuar | Synimi për shtrirjen në të gjithë vendin është pozitiv, por i pamundur. Funksionimi i iniciativës qytete miqësore të fëmijëve kërkon ngritjen dhe funksionimin e një sistemi akreditimi ne nivel qendror, dhe burime per ngritje kapacitetesh ne nivel local per hartimin e planeve dhe me se shumti te zbatimit te tyre. Gjithsesi, ne kuader te komenteve te marra nga 3 bashki u bë 6 bashki. |
| Në zbatim të VKM Nr 584, datë 28.08.2003 “Për miratimin e rregullores së Këshillit të ministrave”, i ndryshuar, në të cilën duhet të përcaktohet shkalla e përputhshmërisë së synuar të projektakteve | Kërkohe saktësimi i pikës V të relacionit shoqërues të këtij projektvendimi | Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme | Pranuar | Në pikën 5 të relacionit është reflektuar komenti për sugjerimin e dhënë |
| | Në relacion kërkojmë nga ana juaj të | Ministria e | Pranuar | Adresuar plotësisht |

| | | | | |
|--|--|-------------------------------------|---------|--|
| | <p>paraqitet një analizë më e detajuar e akomodimit të kostos për vitet 2021-2023, e disagreguar dhe në nivel produkti dhe me tregues performance, për të lidhur efektin financiar për çdo vit, përgjatë periudhës 2021-2024 dhe në vijim, pavarësisht kostimit të paraqitur nga ana juaj në planin e veprimit.</p> <p>Gjithashtu në relacion të paraqitet informacion më i detajuar sipas burimit të financimit, pra kostoja që do të mbulohet nga Buxheti i Stetit e ndarë sipas Buxhetit Qëndror dhe Buxhetit Vendor, sa parashikohet të mbulohet nga donatorët si dhe alternativat e mundshme për financimin e hendekut financiar,</p> | Financave dhe Ekonomisë | | <p>Pika IX e relacionit ka një argumentim më të zgjeruar në përgjigje të komentit të MFE. U vendos në relacion analiza e detajuar në nivel qëllimi politik për periudhën 2021-2024. Analiza e detajuar në nivel masash të lidhura me programet buxhetore jepet në formatin 2. <i>Në planin e veprimit reflektohet e gjithë analiza sipas kërkesave të IPSIS. Në relacion është përfshirë informacion i detajuar sipas burimeve të financimit</i></p> |
| | <p>Referuar planifikimit në masën I.1.2, në planin e veprimit "<i>Përmirësimi i mekanizmave për buxhetimin për fëmijët</i>", në të cilën është parashikuar kostoja respektive në programin buxhetor "<i>01120 Menaxhimi i Shpenzimeve Publike</i>", vlerësojmë të rishikohet kostimi i kësaj mase, për sa kohë ky program buxhetor nuk planifikon fonde për për këtë qëllim, si dhe është jashtë fushës së saj të përgjegjësisë. I njëjti qëndrim vlen dhe për masën III.2.1, "<i>Përmirësimi i qasjes të fëmijëve dhe adoleshentëve në nevojë në programet e mbrojtjes sociale</i>".</p> | Ministria e Financave dhe Ekonomisë | Pranuar | |
| | <p>Gjithashtu, për masën II.2.1, në planin e veprimit "<i>Përmirësimi i kuadrit normativ</i> ,</p> | Ministria e Financave dhe | Pranuar | |

| | | | | |
|--|---|-------------------------------------|----------|--|
| | <i>buxhetor dhe raportues për mbrojtjen e fëmijës", në të cilën është cituar dhe Programi Buxhetor "(10) Planifikim, Menaxhim dhe Administrim", në ministrinë përgjegjëse për financat, vlerësojmë të rishikohet kostimi i kësaj mase, në përputhje me institucionet përgjegjëse për këtë qëllim.</i> | Ekonomisë | | |
| | Lidhur me parashikimin që një pjesë e aktiviteteve parashikohen të fillojnë në vitin 2021, dhe në kushtet që një pjesë e konsiderueshme e vitit ka kaluar, sugjerojmë të rishikohet dhe një herë afati i fillimit të këtyre aktiviteteve, për të bërë të mundur zbatimin e tyre në kohe dhe me efektivitet. | Ministria e Financave dhe Ekonomisë | Refuzuar | Afati i fillimit nuk mund të rishikohet, pasi plani është konceptuar për periudhën 2021-2026. Masat që zbatohen në vitin 2021 janë të buxhetuara. |
| | Të gjitha komentet që ka dhënë Ministria e Arsimit dhe Sportit kanë të bëjnë me ndryshimin e terminologjisë, sipas përcaktimeve ligjore përkatëse. | Ministria e Arsimit dhe Sportit | Pranuar | Të gjitha komentet janë të reflektuara |
| | Në masat II.2.1.1, II.2.2.e dhe II.2.2.ë, të shtohet si institucion përgjegjës edhe Policia e Shtetit | Ministria e Brendshme | Pranuar | Lidhur me masat II.2.1.1, II.2.2.e dhe II.2.2.ë janë reflektuar komentet, duke shtuar si institucion përgjegjës edhe Policinë e Shtetit. |
| | Kudo në përmbajtjen e projektaktit termi "kombësi" të zëvendësohet me termin përkatës të prashikuar në Ligjin nr 113/2020 "Për shtetësinë". | Ministria e Brendshme | Pranuar | Termi "kombësi" është zëvendësuar në çdo pjesë në përmbajtjen e projektaktit me termin përkatës "shtetësi", sipas Ligjit nr 113/2020 "Për shtetësinë". |
| | | Ministria e Brendshme | Pranuar | Projektakti nuk është dërguar për mendim te Komitetet Rajonale Antitrafik, pasi ky dokument iu është dërguar për mendim, vetëm |

| | | | | |
|--|--|-----------------------|----------|---|
| | | | | ministrive të linjës, si edhe Ministrisë së Brendshme, që koordinon çështjet që lidhen me antitrafikimin. |
| Në tabelën e inidikatorëve, konkretisht “Norma e fëmijëve dhe viktima të mundshme të trafikimit për 100 000 popullatë respektive”, të rishikohet vlera | Nisur nga të dhënat që Drejtoria e Migracionit dhe Antitrafikut grumbullon për viktimat e trafikimit, trendi i viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit është konstant. | Ministria e Brendshme | Refuzuar | Lidhur me tabelën e inidikatorëve, lidhur me “Norma e fëmijëve dhe viktima të mundshme të trafikimit për 100 000 popullatë respektive”, këto të dhëna janë marrë nga INSTAT, ku janë llogaritur treguesit për vlerat absolute dhe normat, per llogaritjen e popullatës. (Botim i INSTAT, “Treguesit e Mirëqenies së Fëmijëve, Adoleshentëve dhe të Rinjve në Shqipëri, 2016-2019”). |
| Rishikimi/Harmonizimi i Kodit të Familjes (Rishikim dhe Amendamente) me ndryshimet ligjore dhe nënligjore të Ligjit 18/2017 për çështjet e mbrojtjes së fëmijëve dhe ligje të tjera që përmbajne parashikime specifike për mbrojtjen dhe trajtimin e fëmijëve si (ligji për Azilin, Ligji për “Të huajt ” etj. | Ligji i ri “Per te Huajt” sapo u miratua ne Kuvend. Mund te konsiderohet kontributi në aktet nenligjore per te siguruar sinergji me aktet ligjore dhe nenligjire per te drejtat dhe mbrojtjen e femijes. | OSBE | Pranuar | Ndryshim i formulimit të masës duke e formuluar si më poshtë: II.2.1.d Miratimi i akteve nënligjore që kanë të bëjnë me fëmijët për Ligjin për të Huajt të miratuar në 2021 |
| Hartimi i propozimeve për zgjerimin e strukturës së Agjencisë së Fëmijëve (ASHMDF) për të forcuar kapacitetet për monitorimin dhe raportimin e të drejtave të fëmijëve -Miratimi i propozimeve | Pse duhet specifikuar miratimi si nje mase? Mund ta kemi si indicator: Nr I propozimeve te miratuara | Save the children | Pranuar | Është formuluar si një masë e re: 1.1.1.c Fuqizimi i kapaciteteve të ASHMDF, përfshirë rishikimin e strukturës dhe zhvillimin e kapaciteteve të stafit. |

| | | | | |
|--|--|------------------|---------|---|
| Funksionimi i Qendrës për e Parandalimin e Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve | Tdh ka krijuar nje model praktike te mire qe mundtemerret per baze si dhe ka propozuar nje formular te raportimit te procesit te riintegrimit qe mund te miratohet e perdoret nga QPKMR | Terre des Hommes | Pranuar | Është formuluar si një masë e re: III.4.1. ë Ngritja e kapaciteteve të punonjësve të Qendrës së Parandalimit të krimeve të të miturve dhe të rinjve me qëllim realizimin e veprimtarisë rehabilituese dhe riintegruese nëpërmjet mbikëqyrjes dhe mbrojtjes të të miturve pas kryerjes së dënimit |
| Nr. i planeve sociale të rishikuara | Duhet te kete nje mase ose aktivitet qe shpreh pjesemarrjen e femijeve ne proceset vendimmarrese qe afektojne jeten e tyre. Psh mund te jete i shprehur ne formen e nje indikatorit te shtuar tek ky udhezues. | World Vision | Pranuar | Është riformuluar si tregues tek Objektivi i specifik I.1: Institucione dhe mekanizma të fuqizuar në funksion të respektimit, mbrojtjes dhe përmbushjes së të drejtave të fëmijëve Treguesi: Numri i NJVV me mekanizma / forume funksionale të përfshirjes së fëmijëve në vendimmarrje/numri i fëmijëve të përfshirë |
| | | | | |
| | | | | |

